



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 36, Datë 29.05.2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 8, datë 31.01.2017, e z. G.T., ku pretendohet diskriminim, nga ana e Koorporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) Tiranë, për shkak të “*bindjeve të tij politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I :

Mbështetur në formularin e ankesës, z. G.T., lindur dhe banues në qytetin e Shkodrës, ka filluar punë si elektrikist pranë KESH, në njësinë prodhuese HEC, Vau i Dejës, Shkodër, më datën 15.09.2008. Ai sqaron se më datën 15.08.2016, punëdhënësi i tij ka vendosur prishjen e njëanshme të kontratës së punës, pa asnjë motivacion. Edhe pse ka bërë kërkesë pranë koorporatës për rishikimin e vendimit, ankuesi pretendon se nuk i është kthyer asnjë përgjigje. Sipas tij, arsyeja e vërtetë e largimit nga puna lidhet me bindjet e politike, pasi ai është anëtar i subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë. Për këtë shkak, z. G.T. pretendon se është diskriminuar nga punëdhënësi i tij, KESH.

Në vijim të procedurës për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri ndoqi hapat si më poshtë:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Për sa më lart, si dhe referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përfshihet në fushën e veprimtarisë së Komisionerit dhe ankuesi legjitimohet në paraqitjen e saj.

1. Me shkresën Nr.103/3 prot, datë 16.02.2017 të Komisionerit, KESH, Tiranë është njoftuar për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe iu kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga z. G.T.

➤ Me shkresën me nr. 875/1 prot, datë 15.03.2017, KESH, Tiranë ka vënë në dispozicion të Komisionerit aktet e mëposhtme:

- Vendimin përfundimtar për zgjidhjen e kontratës së punës të z. G.T., nr. 3747/3 prot, datë 12.05.2016;
- Procesverbalin e takimit për zgjidhjen e kontratës së punës, nr. 3747/2 prot, datë 09.05.2016;
- Njoftim mbi fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e kontratës së punës nr. 3747/1 prot, datë 28.04.2016;
- Kontratë individuale pune, nr. 2742/1 prot, datë 15.04.2014.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, në zbatim të urdhrin nr. 36, datë 15.03.2017, të Komisionerit, më datën 20.03.2017, u zhvillua inspektim pranë KESH, në Tiranë.

➤ Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të inspektimit, u konstatua se ankuesi G.T., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për gjykimin e çështjes. Referuar kërkesë padisë, në pikën 3 (tre) të objektit të saj është kërkuar nga gjykata *“të konstatojë faktin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe i viktimizimit të paditësit nga veprimet e ndërgjyqësve të paditur”*. Ankuesi ka kërkuar përfaqësimin në këtë gjykim edhe të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në cilësinë e palës së tretë. Mbështetur në fletëthirrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. akti 691, datë 07.02.2017, më datën 27.02.2017, ka filluar gjykimi i çështjes, nga ana e kësaj gjykate.

Sa më sipër, në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Në kushtet kur kjo çështje e z. G.T. është objekt i gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, Komisioneri **nuk mund të shprehet**, lidhur me ankesën nr. 8, datë 31.01.2017.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 36 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1,3,5,7 dhe 10, si dhe nenit 36, pika 2 e 3 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 8, datë 31.01.2017, e G.T., për shkak se çështja është objekt gjykimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Ky vendim mund të kundërshtohet gjyqësisht, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

IRMA BARAKU

Shkak – bindja politike
Fusha –punësim
Lloji i vendimit - pushim shqyrtimi